



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë), nenit 40 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas një denoncimi të dorëzuar nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK), në vazhdimin e dytë të seancës së tij të 84-të të mbajtur më 31.03.2023, vendosi si më poshtë:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-7884/1 të datës 18.08.2022, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm.

Lënda me numër 12-7884 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-7884/1 të datës 07.08.2022 është formuar në bazë të denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i panjohur. Në denoncim janë paraqitur pretendime për /// të funksionarëve të mëparshëm. Nga KSHPK-ja kërkohet që ta hulumton rastin në pajtim me kompetencat e tij ligjore. Në shtojcë të denoncimit nuk janë dorëzuar prova.

Pas këqyrjes në përmbajtjen e denoncimit KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent. Personat e denoncuar nuk janë mbajtës të funksioneve publike, për arsye se KSHPK-ja nuk ka bazë të ndërmerr veprime nga kompetencat e saj ligjore.

Në përputhje me të theksuarën më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar :
- Arkivi i KSHPK-së.

Përpiloi: Mr. D.D
Miratoi: S.P.D

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
NËNKRYETAR,
Katica Nikolovska**